



Kryetari / President Prodhuesi / Produced Punonjësi / Employee			
02.12.2021			
Emri i Matës Name of Applicant	Numri i Shërbimit	Shërbimi Emri i Shërbimit	Numri i Shërbimit
SKUMBHOK	6781/2021		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.872/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Rushit Kajtazi zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.872/2021, të datës 19.10.2021, të parashtruar nga grup ankuesish

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokate nga Vushtrria, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike " *Kompensim material* ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 02.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr. 872/2021, e datës 19.10.2021, e parashtruar nga ankuesit

dhe

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve

A r s y e t i m

Grup Ankuesish të punësuar në Policinë e Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim avokates me datë 19.10.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për

kompensimin e shpërblimit nga një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt (pagës së trembëdhjetë) dhe shujtave ditore për vitin 2018, 2019 dhe 2020, ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.10.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 08.11.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë si dhe shkresat ndërlidhur me çështjen.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, për vendosje në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 19.10.2021 me numër protokolli 5093/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vërtetimi i punësimit i datës 25.03.2021, për Autorizimi i datës 28.06.2021, për Avokaten nga ankuesi

Vërtetimi për punësim i datës 07.04.2021, për Autorizimi i datës 15.06.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 01.04.2021, për punësim i datës 01.04.2021, për nga ankuesi Autorizimi i datës 28.06.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 01.04.2021, për nga ankuesi Autorizimi i datës 15.06.2021, për Avokaten nga ankuesi

Vërtetimi për punësim i datës 14.06.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 31.03.2021, për Autorizimi i datës 09.07.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 07.07.2021, për nga ankuesi Autorizimi i datës 15.06.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 01.04.2021, për nga ankuesi

Autorizimi i datës 04.05.2021, për Avokaten nga ankuesi Autorizimi i datës 04.05.2021, për Avokaten nga ankuesi Autorizimi i datës 04.05.2021, për Avokaten nga ankuesja Formuari për Vlerësimin të performancës për Autorizimi i datës 15.06.2021, për Avokaten nga ankuesi Autorizimi i datës 02.04.2021, për Avokaten nga ankuesja Autorizimi i datës 22.04.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 21.04.2021, për Vërtetimi për punësim i datës 07.04.2021, për nga ankuesi

Autorizimi i datës 18.05.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 19.04.2021, për Avokaten nga ankuesi Autorizimi i datës 22.04.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 21.04.2021, për nga ankuesi

Autorizimi i datës 02.04.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 30.03.2021, për Autorizimi i datës 11.05.2021, për Avokaten nga ankuesja Autorizimi i datës 19.04.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 29.03.2021, për Vërtetimi për punësim i datës 29.03.2021, për nga ankuesi

Vërtetimi për punësim i datës 27.09.2021, për Autorizimi i datës 24.09.2021, për Avokaten nga ankuesi Vërtetimi për punësim i datës 23.09.2021, për nga ankuesin Autorizimi i datës 27.09.2021, për Avokaten nga ankuesin Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për

Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015,

për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës
 e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për
 Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015,
 për Kontrata e punës e datës 20.08.2014, për Kontrata e
 punës e datës 27.07.2004, për Kontrata e punës e datës 19.08.2014, për
 Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e
 datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për
 Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për
 datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për
 Kontrata e punës e datës 08.06.2012, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015,
 për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës
 e datës 11.09.2015, për Kontrata e punës e datës 11.09.2015, për
 Përgjigje në kërkesë e datës 17.05.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 13.08.2021; Përgjigje në
 kërkesë e datës 25.05.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 10.06.2021; Përgjigje në kërkesë e datës
 02.06.2021; Përgjigje në ankesë e datës 08.11.2021, me numër protokolli 5334/2021; e-maili nga
 KPMSHCK i datës 24.1.2021 lidhur me deklarinimin statusit, përgjigje përmes emailit të datës
 01.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të
 parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën e I të dispozitivit të
 këtij vendimi, është e **pabazuar, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesit janë të punësuar në në Policinë e
 Kosovës me statusin e nëpunësit civilë gjegjësisht sipas kontratave të punës ankuesi

ka pozitën e punës "Asistent Administrativ, Divizioni i Njësive të Specializuara,
 ankuesi ka pozitën e punës "Asistent Administrativ" në Njësine për
 Mbrojtjen e Afërm./Drejtoria për Sigurimin e Objekteve me Rendësi të Veçante dhe
 Personaliteteve, ankuesi ka pozitën e punës "Asistent Administrativ", në
 Stacionin Policor Vushtrri/ Drejtoria rajonale Mitrovicë e Jugut, ankuesja ka
 pozitën e punës "Shef i Sektorit", në Stacionin Policor Vushtrri/Drejtoria Rajonale Mitrovicës
 së Jugut, ankuesi ka pozitën e punës "Zyrtar i Personelit" në Stacionin
 Policor Vushtrri/Sektori i Resurseve Mitrovica e Jugut; ankuesja ka pozitën e
 punës "Zyrtar për Autorizimin e Armëve", Stacioni Policor Vushtrri/Drejtoria Rajonale
 Mitrovica e Jugut, ankuesi ka pozitën e punës "Zyrtar i Personelit", Divizioni i
 Njësive të Specializuar, ankuesja ka pozitën e punës "Asistente
 Administrative", Njësia Speciale Operative, Drejtori e Përgjithshme, ankuesi ka
 pozitën e punës "Zyrtar i lartë i mirëmbajtjes së pajisjeve të IT - së", Sektori Mbështetës TIK,
 Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikim, dhe ankuesi ka
 pozitën e punës "Zyrtar i lartë i mirëmbajtjes së pajisjeve të IT" Sektori Mbështetës TIK,
 Drejtoria e Teknologjisë Informative dhe Komunikim.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për
 Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i
 zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar
 përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për
 Policinë e Kosovës.

Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: ... 2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione..., 3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërtime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet e pensionit; 4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe beneficionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtarët policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke marrë parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me datë 09.07.2020 ka nxjerr Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë sa nuk cenojnë pavarësinë funksionale dhe organizative të Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke iu referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve si në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi, *sepse*:

Lidhur me Ankuesit në pozitën e punës "Radikomunikues", Njësia Operative Rajonale e Komunikacionit Rrugor/Drejtoria Rajonale Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Nëpunës", Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Zyrtar i bazës së të dhënave (SIPK)" Sektori i Operative Rajonale, Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovica e Jugut; nëpunës administrativ mbështetës, në pozitën e punës "Radikomunikues" Stacioni Policor Vushtrri, Drejtoria Rajonale Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Asistent-regjistrimi i tiketave" Stacioni Policor Vushtrri, Drejtoria Rajonale Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Zyrtar i bazës së të dhënave (SIPK)" Sektori i Operatives Rajonale Zyra e SIPK- ut, Drejtoria Rajonale Prishtinë, në pozitën e punës "Nëpunës" Stacioni Policor Vushtrri, Drejtoria Rajonale Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Radikomunikues", Stacioni Policor Vushtrri, Drejtoria Rajonale Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Zyrtar në MTO, dhe Logjistike" Njësia Speciale Operative /NJSO Mitrovicë, në pozitën e punës "Pastruese" Drejtoria e Përgjithshme Prishtinë, ankuesja në pozitën e punës "Pastruese", Drejtoria e Përgjithshme Prishtinë, ankuesja në pozitën e punës "Pastruese", Drejtoria e Përgjithshme Prishtinë, ankuesja në pozitën e punës "Mirëmbajtës" Stacioni Policor Vushtrri, Drejtoria Rajonale Mitrovica e Jugut, në pozitën e punës "Pastruese" Sektori i Mirëmbajtjes/Drejtoria e Menaxhimit të Objekteve, Kolegji konstaton së këto pozita të punës duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenit 2 paragrafi 2.4 hyjnë në kategorinë e nëpunësve administrative teknik dhe mbështetës ku përcaktohet se *Nëpunës administrativo- teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike* dhe si rrjedhojë ankuesit si ne piken 2 të dispozitivit nuk e kanë statusin e Nëpunësit Civil, kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e Nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se Nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 872/2021

Rushit Kajtazi

Përcësmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueseve avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.